



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.75

2005

20 tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.7, datë 13.10.2005	Për mosmiratimin e projektligjit “Për ratifikimin e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelekom”” dhe ekspertizën ndërkombëtare në lidhje me të	2503
Urdhër i MF	Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve në lojërat e fatit.....	2503
Vendim i GJK nr.23, datë 13.10.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.84, datë 18.2.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe të nenit 436, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale, si antikushtetues.....	2504
Vendim i ERU nr.1, datë 10.1.2005	Për miratimin e tarifave të ujit, sh.a. ujësjellësi Kukës.....	2507
Vendim i ERU nr.2, datë 20.2.2005	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik, sh.a. ujësjellës-kanalizime Gjirokastër.....	2508
Vendim i ERU nr.3, datë 1.6.2005	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik, sh.a. ujësjellës-kanalizime Librazhd.....	2508
Vendim i ERU nr.6, datë 26.8.2005	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik, sh.a. ujësjellës-kanalizime Sarandë.....	2509
	Ndreqje gabimi.....	2510

VENDIM
Nr.7, datë 13.10.2005

**PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS PËR
BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME “ALBTELEKOM””
DHE EKSPERTIZËN NDËRKOMBËTARE NË LIDHJE ME TË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për ratifikimin e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelekom””.

II. Këshilli i Ministrave të sigurojë ekspertizë ndërkombëtare në lidhje me formulimet e kontratës, si dhe për ligjshmërinë e procedurave të ndjekura në privatizimin e “Albtelekom” sh.a.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

URDHËR
PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 "Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", i ndryshuar, në vijim të përmirësimit të punës, Ministri i Financave

URDHËRON:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për lojërat aritmetike
 - a) Për bingo, fondi i ngurtësimit për shoqërinë të përcaktohet sipas kategorizimit të qyteteve:
 - Për qytetet e kategorisë së I^{re} (Tiranë dhe Durrës), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 - Për qytetet e kategorisë së II^{te} (Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat dhe Kavajë), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
 - Për qytetet e kategorisë së III^{te} (të gjitha qytetet e tjera), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
 - Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
 - b) Për lojërat aritmetike që zhvillohen për pjesëmarrës jashtë sallave, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.
2. Për lojërat e fatit sportive
 - a) Kategoria "Basti", fondi i ngurtësimit të jetë në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.
 - b) Kategoria "Konkurs për parashikimet sportive", fondi i ngurtësimit të jetë në masën

1 000 000 (një milion) lekë.

3. Për llotaritë

a) Llotari me shorte, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) Llotari të çastit, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për çdo llotari (leje) të organizuar. Ky fond do të çngurtësohet vetëm pas përfundimit të çdo llotarie (lojë).

4) Lojërat elektronike. Për lojërat elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

Shoqëritë e licencuara të lojërave të fatit, janë të detyruara të plotësojnë fondin e ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve të lojërave të fatit brenda datës 31.12.2005.

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve.

Urdhri nr.2152, datë 2.4.2002, me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Çdo urdhër që i bie ndesh këtij urdhri shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

VENDIM

Nr.23, datë 13.10.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalice, në datat 13.1.2005 dhe 19.1.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31 Akti që i përket:

KËRKUES: ILIR XHAKJA, përfaqësuar nga avokat Edmond Hyka, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.84, datë 18.2.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe nenit 436 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është antikushtetues për këto arsye:

Së pari, nuk është respektuar e drejta për t'u mbrojtur vetë ose me ndihmën e avokatit. Gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në mungesë të të pandehurit, pa qenë ai i pranishëm personalisht dhe as i mbrojtur me avokat, qoftë edhe kryesisht. Rekursi i prokurorit nuk i është komunikuar drejtpërdrejt të pandehurit, sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurës Penale. Nga ky gjykim është rënduar në mënyrë të dukshme pozita e të gjykuarit, duke i ndryshuar masën e dënimit;

Së dyti, mënyra e njoftimit që vjen nga zbatimi i nenit 436/3 të Kodit të Procedurës Penale, përmban antikushtetutshmëri. Kjo dispozitë cenon të drejtat kushtetuese të të pandehurve, sepse njofton vetëm prokurorin dhe injoron njoftimin e datës së gjykimit për të pandehurin. Mënyra e

njoftimit me afishim 10 ditë më parë është një zgjidhje e pamjaftueshme për të realizuar efektivisht qëllimin e njoftimit të personave të interesuar dhe cenon parimin e barazisë së palëve në proces.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuari është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale të armëmbajtjes pa leje dhe është dënuar me 350 000 lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.255, datë 9.9.2003, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka ndryshuar vendimin e të dyja gjykatave përse i përket llojit të dënimit dhe e ka dënuar kërkuarin me 3 vjet burgim.

Çështja në shqyrtim është gjykuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori. Në dosjen gjyqësore nuk rezulton që komunikimi i rekursit t'i jetë bërë kërkuarit ose avokatit të tij, ndërkohë që ndodhet një dëftesë komunikimi rekursi, për të cilin ka nënshkruar i vëllai i të pandehurit. Ndodhur në këto kushte, Gjykata e Lartë, ka zhvilluar seancën gjyqësore në prani vetëm të prokurorit, duke i ndryshuar vendimet e gjykatave, përse i përket llojit dhe masës së dënimit.

Kërkuari, pretendimin për shkelje të së drejtës për një proces të rregullit ligjor e ka përqendruar kryesisht në zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, pa praninë e mbrojtësit ose të të gjykuarit. Problemi që shtrohet për t'u zgjidhur përpara Gjykatës Kushtetuese, për çështjen në shqyrtim, është i fokusuar në drejtim të rregullsisë ose jo të procesit ligjor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, në mungesë të kërkuarit dhe të avokatit të caktuar prej tij, ndërkohë, që çështja është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të prokurorit.

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, mënyra e zhvillimit të gjykimit në varësi të specifikës së çdo rasti konkret, është konsideruar pjesë përbërëse e juridiksionit të saj kushtetues, në kuptim të neneve 42 dhe 131, shkronja "P" të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke iu referuar praktikës gjyqësore ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, konstatohet se përgjithësisht pranohet që seancat gjyqësore nuk mund të zhvillohen pa praninë e avokatit. Prandaj, njoftimi i avokatit lidhur me ankimin e ushtruar në shkallët e larta të gjykimit konsiderohet i mjaftueshëm. Pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim në gjykatat e larta, nuk është automatikisht e domosdoshme (me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë), sepse debati zhvillohet për çështje të ligjit.

Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë.¹

Është e pranueshme që shteti nuk mund të bëhet përgjegjës për çdo mungesë nga ana e një avokati, por në rrethana të veçanta u takon autoriteteve kompetente të ndërmarrin hapa për të siguruar që aplikanti të gëzojë të drejtat e tij të njohura e të pranuar.²

Përfaqësimi me avokat në Gjykatën e Lartë synon garantimin e një mbrojtjeje sa më efektive dhe sa më profesionale të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Jurisprudenca jonë kushtetuese, në respektim edhe të qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka konkluduar se trajtimi nga Gjykata e Lartë vetëm i problemeve ligjore, jo vetëm që justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat, por për më tepër është i domosdoshëm për garantimin e një mbrojtjeje efektive dhe të dobishme, gjithnjë në favor të të pandehurit. Në çështjen "Pakëll kundër Gjermanisë", Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vë në dukje, ndër të tjera, se nisur nga natyra

¹ Çështja "T" kundër "I", marrë nga Komentari i KEDNJ Frowin/Puekert.

² Artico kundër Italisë, vendim i Gjykatës së Strasburgut, 13.5.1980

e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe fokusimin e saj në çështje të ligjit, “pa ndihmën e një avokati, procesi nuk mund të kontribuonte në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndronin në thelb të mosmarrëveshjeve”.³

Konkluzione të tilla që përcaktojnë njëkohësisht dhe standardet minimale dhe që garantojnë rregullsinë e një procesi gjykimi, kanë qenë dhe janë të rëndësishme për jurisprudencën kushtetuese shqiptare, dhe në mënyrë të veçantë, për të konkluduar për rastin në shqyrtim.

Nëpërmjet këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese nuk merr përsipër të ndryshojë a të modifikojë qëndrimet e mbajtura dhe interpretimet ligjore të kryera nga Gjykata e Lartë, por të analizojë rastin në shqyrtim në dimensionin kushtetues, me qëllim dhënien përgjigje pretendimeve të kërkuarit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Nisur nga qëndrime të tilla të jurisprudencës europiane dhe duke marrë shkas nga rasti në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se situata juridike, kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëjlojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij nuk është e domosdoshme nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit.⁴ Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj.

Ndryshe paraqitet situata, kur si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohej pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Gjykata e Lartë, kur ka gjykuar këtë rast konkret, me përjashtim të argumenteve të paraqitura nga prokurori, nuk ka pasur të administruar asnjë argument ligjor nga pala e akuzuar. Çështja vështirësohet edhe për arsye se me paraqitjen e rekursit nga prokurori, Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon mundësinë e paraqitjes së kundërrekursit nga pala kundërshtare. Pjesëmarrja e të gjykuarit dhe, në mënyrë të veçantë, e avokatit të tij kërkohet për të siguruar jo vetëm të drejtën për t’u mbrojtur, por edhe respektimin e parimit të barazisë së armëve në një proces ligjor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se koncepti i ndihmës së mbrojtësit nuk identifikohet domosdoshmërisht me praninë personale të të pandehurit në gjykim, por kuptohet si një garanci e pashmangshme e mundësisë për t’u mbrojtur, që në rastin e gjykimit përpara Gjykatës së Lartë është gjerësisht e siguruar përmes njohjes dhe kujdesit për të interesuarin të një sërë të drejtash procedurale të lidhura saktësisht me ndihmën e mbrojtësit. Për këtë arsye, në rastin në shqyrtim paraqitej e domosdoshme pjesëmarrja e avokatit.

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut mbrojnë interesat e të pandehurit në një proces, sepse është ai që do të preket drejtpërdrejt nga pasojat e një procesi të zhvilluar pa pjesëmarrjen e tij dhe të avokatit.

Nisur nga specifika e rastit në shqyrtim, kur çështja shqyrtohej mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili ka kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit dhe faktit, që as i pandehuri dhe as avokati nuk ishin të pranishëm në gjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin pa u garantuar për arsyet e mosparaqitjes së tyre dhe pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo ishte e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të merrte pjesë në debatet e mundshme.

Pretendimin tjetër të kërkuarit, për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 436 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Kushtetuese nuk e çmon të arsyeshme ta analizojë për shkak se kërkuari e ka përdorur këtë pretendim në funksion të argumenteve që kanë të bëjnë me cenimin e procesit ligjor, të cilat u pranuan gjatë arsyetimit të këtij vendimi.

Përfundimisht, nga analiza që iu bë pretendimeve të kërkuarit, për shkak të specifikës së rrethanave që paraqiste çështja në shqyrtim, si dhe të mënyrës së përfundimit të saj, Gjykata Kushtetuese konkludon se procesi ligjor i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

3 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, nr. 25 datë 30.7.2003, Përmbledhje vendimesh, 2003, faqe 134.

4 Frowein/Peukert, Europäische Menschenrechtskonvention-Kommentar (1996) faqe 227.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 shkronja “f” dhe 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.84, datë 18.2.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.1, datë 10.1.2005

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT
SHA UJËSJELLËSI KUKËS**

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, i miraton:

Emri i subjektit: sh.a. ujësjellës Kukës;

Zona nën juridiksion: Qyteti Kukës me popullsi 28 300 banorë.

Tarifën për shitje uji komunave Shtiqën dhe Bicaj:

- 15 lekë/m³

Ky vendim hyn në fuqi në datën e lidhjes, më 1.2.2004 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETAR
Vladimir Meksi**

VENDIM

Nr.2, datë 20.2.2005

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME GJIROKASTËR**

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, i miraton:

Emri i subjektit: sh.a.ujësjellës Gjirokastër;

Zona nën juridiksion: Qyteti i Gjirokastrës, me popullsi rreth 23 700 banorë.

Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

Konsumatori familjar: 20.4 lekë/m³

Institucionet buxhetore: 70 lekë /m³

Privatët: 90 lekë /m³

Ky vendim hyn në fuqi, më 1.3.2004 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETAR
Vladimir Meksi**

VENDIM
Nr.3, datë 1.6.2005

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LIBRAZHD

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, i miraton:

Emri i subjektit: sh.a. ujësjellës-kanalizimeve Librazhd;

Zona nën juridiksion: Qyteti Librazhd dhe qyteti Prrenjas me 18 000 banorë.

Tarifat e ujit për konsum publik si më poshtë:

Për ujin e pijshëm: Për ujërat e përdorura:

Konsumatori familjar: 28 lekë/m³ 8 lekë/m³

Institucionet buxhetore: 60 lekë/m³ 10 lekë/m³

Entet private: 80 lekë/m³ 12 lekë/m³

Ky vendim hyn në fuqi, më 1.7.2005 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Vladimir Meksi

VENDIM
Nr.6, datë 26.8.2005

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME SARANDË

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, i miraton:

Emri i subjektit: sh.a. ujësjellës-kanalizimeve Sarandë

Zona nën juridiksion: Qyteti Sarandë dhe fshatrat Gjashtë dhe Metoq me rreth 35 000 banorë.

Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

Për ujin e pijshëm:

Konsumatori familjar: 34 lekë/m³

Institucionet buxhetore: 78 lekë/m³

Entet private: 105 lekë/m³

Shitje ujë me shumicë: 13 lekë/m³

Për kanalizimet;

Konsumatori familjar: 7 lekë/m³

Institucionet buxhetore: 10 lekë/m³

Entet private: 17 lekë/m³

Ky vendim hyn në fuqi, më 1.9.2005 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Vladimir Meksi

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.37/2005 në ligjin nr.9377, datë 21.4.2005 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”” bëhen këto ndreqje:

Ishte:

Bëhet:

“Neni 16

“Neni 16

Pika 3 e nenit 24 ndryshohet si më poshtë:

“3.Përfituesit që kanë në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë ose janë të paaftë për punë deri në 25 vjeç, përftojnë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të të ardhurave nga papunësia, por jo më shumë se 30 për qind. Kur njëri nga prindërit është në marrëdhënie pune ose merr pension të plotë, shtesa reduktohet në masën 50 për qind.”.

“Neni 40

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, 13, 17, 18, 20 dhe 27 të këtij ligji.”

Pika 3 e nenit 54 ndryshohet si më poshtë:

“3.Përfituesit që kanë në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë ose janë të paaftë për punë deri në 25 vjeç, përftojnë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të të ardhurave nga papunësia, por jo më shumë se 30 për qind. Kur njëri nga prindërit është në marrëdhënie pune ose merr pension të plotë, shtesa reduktohet në masën 50 për qind.”.

“Neni 40

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, 17, 18, 20, 22 dhe 27 të këtij ligji.””

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar pranë:

- njësisë postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,

pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"

Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim,2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
8.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
9.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim,2005)	500
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 20.10.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 100 lekë